VENDIM
Nr. 486, datë 1.8.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 347, DATË 22.5.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE TË PROCEDURAVE TË TRANSFERIMIT TË MENAXHIMIT TË INFRASTRUKTURËS SË PESHKIMIT TEK ORGANIZATAT E PESHKIMIT, NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE DHE SUBJEKTET PRIVATE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 65, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 347, datë 22.5.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kreun I bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Kudo në kreun I, fjalët "... ministria përgjegjëse për peshkimin ..." zëvendësohen me "... institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës ...".

b) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Procedura e transferimit të infrastrukturës së peshkimit dhe infrastrukturës së lidhur me peshkimin tek organizata e peshkimit dhe subjektet private zhvillohet *on-line* nëpërmjet konkurrimit publik, sipas parashikimeve të këtij vendimi.".

c) Në pikën 6, pas fjalëve "... ose sipërfaqe për ndërtimin e tyre, ..." shtohen "... qendrave të grumbullimit, tregu i shitjes me shumicë ose sipërfaqja e ndërtimit të tregut,...".

ç) Pika 14 shfuqizohet.

2. Në kreun II bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikën 1, fjalët "... ministria përgjegjëse për peshkimin ..." zëvendësohen me "... institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës ...".

b) Në shkronjën "ç", të pikës 2, fjala "... vendi ..." hiqet.

c) Në fjalinë e parë, të pikës 3, fjala "... vendi ..." hiqet dhe në fjalinë e dytë, togfjalëshi "... 7 (shtatë) ditë kalendarike ..." zëvendësohet me "... 20 (njëzet) ditë kalendarike ...".

ç) Në pikën 4, fjalët "... i dorëzohet komisionit në orën e hapjes së konkurrimit ..." zëvendësohen me "... të cilët duhet të jenë persona fizikë ose juridikë, ngarkohet *on-line* në portalin *"e-Albania*" ...".

d) Në pikën 5, fjalët "... i dorëzohet komisionit ..." zëvendësohen me "... ngarkohet *on-line* në portalin "*e-Albania*"...".

dh) Në pikën 6 bëhen këto ndryshime:

i. Shkronja "a" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"a) Shkarkon dokumentacionin e ngarkuar në portalin "*e-Albania*", ruan një kopje elektronike të tij dhe në rastin kur dokumentacioni është jo i plotë, i paqartë apo i ndryshëm nga ai që kërkohet njofton konkurrentin për të plotësuar të metat brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike. Mosplotësimi i të metave brenda këtij afati përbën shkak për mospranimin e kërkesës.".

ii. Në shkronjën "c", togfjalëshi "... brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve ..." zëvendësohet me "... brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike ...".

e) Në pikën 7, fjala "... ministri ..." zëvendësohet me fjalët "... Komisioni i dhënies me qira ose enfiteozë të pasurisë shtetërore ...".

ë) Në pikën 10, fjalët "... ministria përgjegjëse për peshkimin ..." zëvendësohen me "... institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës ...".

3. Në kreun IV bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 2, fjalët "... ministri përgjegjës për peshkimin ..." zëvendësohen me "... institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës ...".

b) Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"7. Pranë institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës ngrihet një komision i cili, brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga paraqitja e kërkesës, shqyrton propozimin dhe dokumentacionin shoqërues të dorëzuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore dhe, nëse e gjen në përputhje me parashikimet e ligjit dhe të këtij vendimi, i përcjell dokumentacionin, për mendim, Komisionit Konsultativ Qendror për Peshkimin dhe Akuakulturën (në vijim "KKQPA"), i cili vepron sipas parashikimeve të nenit 21, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar.".

4. Në kreun V bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Transferimi i menaxhimit të infrastrukturës së porteve të peshkimit dhe/ose tregut të shitjes me shumicë u bëhet organizatave të peshkimit të përcaktuara në pikën 1, të nenit 58, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, me kërkesë ose kryesisht nga institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës.".

b) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

"1/1. Njoftimi për transferimin e infrastrukturës së porteve të peshkimit dhe/ose tregut të shitjes me shumicë publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike nga institucioni përgjegjës për peshkimin dhe akuakulturën, duke përcaktuar të dhënat e objektit që do të transferohet dhe dokumentacionin që do të paraqesin konkurrentët në portalin "*e-Albania"*. Organizatat e peshkimit kanë të drejtë të paraqesin kërkesën për transferim dhe dokumentacionin e kërkuar brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga publikimi i njoftimit.".

c) Pikat 2 dhe 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"2. Organizata e peshkimit ngarkon *on-line* në portalin "*e-Albania*" kërkesën, vendimin e regjistrimit, aktin e themelimit, statutin, vendimin e organeve vendimmarrëse të organizatës së peshkimit për këtë qëllim, planin e menaxhimit të miratuar nga organet drejtuese të saj.".

"4. Pranë institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës ngrihet një komision i cili, shkarkon dokumentacionin e ngarkuar në format elektronik në portalin "*e-Albania*", ruan një kopje elektronike të tij dhe, brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike, pas përfundimit të afatit të publikimit, shqyrton dokumentacionin e ngarkuar nga organizata e peshkimit.".

ç) Pas pikës 4 shtohen pikat 4/1, 4/2 dhe 4/3, me këtë përmbajtje:

"4/1. Komisioni i ngritur vlerëson planin e menaxhimit sipas këtyre kritereve:

a) investimet e parashikuara;

b) plani për sigurinë e infrastrukturës;

c) cilësia e shërbimit;

ç) kostot operative.

4/2. Komisioni vendos për subjektin fitues në konkurrim dhe bën shpalljen e tij në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe kur në konkurrim marrin pjesë më shumë se një konkurrues, njoftimi për shpalljen e fituesit vendoset edhe në këndin e njoftimeve të institucionit përkatës.

4/3. Pas shpalljes së fituesit, institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës lidh marrëveshjen për transferimin e menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit me subjektin fitues brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike.".

d) Pika 5 shfuqizohet.

dh) Pas pikës 24 shtohet pika 25, me këtë përmbajtje:

"25. Menaxhimi i infrastrukturës së peshkimit, ku përfshihet edhe infrastruktura e porteve, i transferohet vetëm organizatave të peshkimit nëpërmjet konkurrimit publik.".

5. Pas kreut V shtohet kreu V/I, me këtë përmbajtje:

"V/I. TRANSFERIMI I MENAXHIMIT TË TREGUT TË SHITJES ME SHUMICË DHE/OSE QENDRËS SË GRUMBULLIMIT TE SUBJEKTET PRIVATE

1. Procedura e transferimit të një tregu shitjeje me shumicë ose qendrës së grumbullimit kryhet kryesisht nga institucioni përgjegjës për peshkimin dhe akuakulturën ose me kërkesë të një ose disa subjekteve private.

2. Njoftimi për transferimin e tregut të shitjes me shumicë dhe/ose qendrës së grumbullimit publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike nga institucioni përgjegjës për peshkimin dhe akuakulturën, duke përcaktuar të dhënat e objektit që do të transferohet dhe dokumentacionin që do të paraqesin konkurrentët në portalin "*e-Albania"*. Subjektet private kanë të drejtë të paraqesin kërkesën për transferim dhe dokumentacionin e kërkuar brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga publikimi i njoftimit.

3. Subjekti privat i interesuar ngarkon *on-line* në portalin *"e-Albania*" kërkesën, ekstraktin historik të regjistrit tregtar, plan-biznesin dhe deklaratat në formën e vetëdeklarimit për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimet shoqërore, deklaratën se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e ngarkuar.

4. Komisioni i ngritur për transferimin e tregut të shitjes me shumicë pranë institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës shkarkon dokumentacionin e ngarkuar në format elektronik në portalin "*e-Albania*", ruan një kopje elektronike të tij dhe brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike, pas përfundimit të afatit të publikimit, shqyrton dokumentacionin e ngarkuar.

5. Komisioni i ngritur vlerëson planin e biznesit sipas këtyre kritereve:

a) investimet e parashikuara;

b) plani për sigurinë e infrastrukturës;

c) cilësia e shërbimit;

ç) kostot operative.

6. Komisioni vendos për subjektin fitues në konkurrim dhe bën shpalljen e tij në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe kur në konkurrim marrin pjesë më shumë se një konkurrues, njoftimi për shpalljen e fituesit vendoset edhe në këndin e njoftimeve të institucionit përkatës.

7. Pas shpalljes së fituesit, institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës lidh marrëveshjen për transferimin e menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit me subjektin fitues brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike.".

6. Në pikën 6, të kreut VI, fjalët "... ministri përgjegjës për peshkimin ..." zëvendësohen me "... institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës ...".

7. Kudo në aneksin "DRAFTKONTRATË QIRAJE", emërtimi "Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural" zëvendësohet me fjalët "... institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës ...".

8. Marrëveshja tip për transferimin e menaxhimit të infrastrukturës të portit të peshkimit/tregut të shitjes me shumicë, ndërmjet drejtorisë së shërbimeve të peshkimit dhe akuakulturës dhe organizatës së peshkimit/njësive të vetëqeverisjes vendore zëvendësohet me "marrëveshjen tip", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

II. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE TIP
PËR TRANSFERIMIN E MENAXHIMIT TË INFRASTRUKTURËS SË PORTIT TË PESHKIMIT/TREGUT TË SHITJES ME SHUMICË DHE/OSE QENDRËS SË GRUMBULLIMIT NDËRMJET INSTITUCIONI PËRGJEGJËS PËR SHËRBIMET E PESHKIMIT DHE AKUAKULTURËS DHE ORGANIZATËS SË PESHKIMIT/NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE/SUBJEKTEVE PRIVATE

Kjo marrëveshje përbën kuadrin e bashkëpunimit ndërmjet institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës dhe Organizatës së Peshkimit/njësisë së Vetëqeverisjes vendore/subjekteve private. Marrëveshja është hartuar në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë,

Neni 1
Palët

Palët në këtë marrëveshje janë:

- Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës,
- _____, identifikuar me NUIS _____, me adresë në _____, përfaqësuar nga _____.

Neni 2
Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është transferimi i menaxhimit të infrastrukturës së portit të peshkimit/tregut të shitjes me shumicë dhe/ose Qendrës së Grumbullimit tek organizata e peshkimit/njësitë e vetëqeverisjes vendore/subjekteve private, duke përcaktuar kushtet për kryerjen e veprimtarive, të drejtat dhe detyrimet e palëve.

Neni 3
Kohëzgjatja

Kjo marrëveshje ndërmjet palëve të lartpërmendura lidhet për një afat prej _____ vjetësh (jo më shumë se 20 vjet), afat i cili fillon nga momenti i nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

Neni 4
Pronësia

Porti i peshkimit/tregu i shitjes me shumicë/qendra e grumbullimit janë prona publike, infrastruktura e të cilit transferohet tek organizata e peshkimit/njësitë e vetëqeverisjes vendore/subjekteve private.

Neni 5

Territori i infrastrukturës së portit që transferohet në menaxhim

5.1. Sipërfaqet dhe objektet që transferohen në menaxhim identifikohen me genplanin, që i bashkëlidhet marrëveshjes dhe dokumentacionin e lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

5.2. Subjekti, që merr në menaxhim, detyrohet të ruajë sipërfaqen dhe ambientet që merr në menaxhim.

Neni 6

Ruajtja e destinacionit dhe e interesit publik

Organizata e peshkimit/njësia e vetëqeverisjes vendore/subjektet private, gjatë menaxhimit të infrastrukturës së portit dhe të infrastrukturave të lidhura me peshkimin zbatojnë kushtet e parashikuara në ligjin nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, duke garantuar:

a) mosndryshimin e destinacionit dhe qëllimit;

b) përdorimin e infrastrukturës së peshkimit nga ana institucioneve shtetërore në rastet e masave të jashtëzakonshme ose sa herë i kërkohet;

c) ruajtjen dhe garantimin e interesit publik;

ç) ruajtjen dhe rritjen vlerës ekonomike të strukturave portuale të peshkimit që i janë transferuar për menaxhim, duke riparuar infrastrukturën ekzistuese, ndërtimin e infrastrukturave të reja.

Neni 7

Përgjegjësitë e organizatës së peshkimit dhe e njësisë së vetëqeverisjes vendore/subjekteve private

7.1. Organizata e peshkimit/njësia e vetëqeverisjes vendore/subjektet private duhet të përdorin infrastrukturën e transferuar në mënyrë të drejtë e të barabartë, duke iu ofruar mundësinë të gjithë anëtarëve/subjekteve private në portin e peshkimit/tregun e shitjes me shumicë dhe qendrës së grumbullimit, në mënyrë që të nxisin dhe të mbrojnë interesat e tyre.

7.2. Organizata e peshkimit/njësia e vetëqeverisjes vendore/subjekti privat merr përsipër përballimin e kostove të përdorimit dhe të mirëmbajtjes së portit/tregut të shitjes me shumicë dhe përgjigjet për mirëmbajtjen e tij, ku përfshihen mirëmbajtja e ndërtesave të administratës dhe të reparteve ndihmëse, shërbimet e grumbullimit të mbetjeve të ngurta apo të lëngëta të gjeneruara në territorin e portit, sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve, mirëmbajtja e infrastrukturës për furnizim me energji elektrike, karburante dhe ujë të pijshëm, si dhe pagesat kundrejt enteve shtetërore përkatëse, mirëmbajtja e mjediseve higjieno-sanitare të portit/tregut, mirëmbajtja e kalatave, bankinave notuese, kalunave.

7.3. Organizata e peshkimit/njësia e vetëqeverisjes vendore/subjekti privat duhet të administrojë portin e peshkimit/tregun/qendrën në mënyrë racionale, duke zbatuar legjislacionin në fuqi për të nxitur mbrojtjen e mjedisit dhe një zhvillim të qëndrueshëm.

7.4. Organizata e peshkimit/ njësia e vetëqeverisjes vendore/subjekti privat është përgjegjëse për sigurinë dhe sigurimin në territorin që ka në menaxhim.

7.5. Organizata e peshkimit programon dhe merr masa për vendosjen e sigurt të anijeve të peshkimit në kalatë apo bankina notuese, duke respektuar rregullat dhe rregulloret e hartuara për këtë qëllim.

7.6. Organizata e peshkimit krijon kushte për përpunimin e anijeve të peshkimit në port (shkarkimin e peshkut të zënë, furnizimin me karburant, energji elektrike me ujë të pijshëm dhe bazë materiale e teknike të nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së peshkimit).

7.7. Tarifat e qirasë dhe të shërbimeve përcaktohen me udhëzimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për bujqësinë dhe ministrit përgjegjës për financat.

7.8. Të ardhurat e krijuara nga tarifat e qirasë dhe nga ofrimi i shërbimeve, në rastin e organizatave të peshkimit, nuk shpërndahen, por shërbejnë për investime në infrastrukturën e transferuar dhe/ose për rritjen e shërbimeve të ofruara, sipas qëllimit për të cilin kjo infrastrukturë është transferuar.

7.9. Çdo investim i kryer në infrastrukturë pavarësisht nga vlera duhet të marrë më parë miratim nga ministri përgjegjës për peshkimin.

7.10. Organizatat e peshkimit/njësia e vetëqeverisjes vendore/subjektet private janë të detyruara të raportojnë çdo 6 muaj pranë institucionit përgjegjës për peshkimin dhe për akuakulturën lidhur me zbatimin e planit të menaxhimit, veprimtaritë e kryera, të ardhurat e realizuara etj., të shoqëruar me dokumentacion përkatës provues.

7.11. Organizatat e peshkimit/njësia e vetëqeverisjes vendore/subjektet private janë të detyruara të depozitojnë në çdo kohë çdo informacion të kërkuar, si dhe të krijojnë akses për inspektimin nga përfaqësuesit e ministrisë të dokumentacionit teknik e financiar.

Neni 8

Të drejtat dhe përgjegjësitë e institucionit përgjegjës për peshkimin dhe akuakulturën

Institucionit përgjegjës për peshkimin dhe akuakulturën ka të drejtë të inspektojë infrastrukturën e transferuar, dokumentacionin dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe të marrëveshjes.

Neni 9

Inspektimi

Organizata e peshkimit/njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të krijojë të gjitha kushtet për inspektimin nga ana e organeve shtetërore, të ngarkuara nga ligji, të portit dhe të strukturave të lidhura me veprimtarinë e peshkimit që ajo administron.

Neni 10

Marrëdhëniet e organizatës së peshkimit me organet shtetërore[1]

10.1. Marrëdhëniet e organizatës së peshkimit me organet shtetërore rregullohen sipas parashikimeve të nenit 64, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar.

10.2. Kompetencat dhe përgjegjësitë e zyrës së kapitanerisë së portit ndaj anijeve të peshkimit, ekuipazheve të tyre dhe koordinimit të veprimtarive të lundrimit rregullohen në bazë të ligjeve në fuqi dhe të Kodit Detar. Organizata e peshkimit bashkëpunon me kapitanerinë si në drejtim të këmbimit të informacionit të mbërritjes e largimit të anijeve, ashtu edhe për lëvizjen e anijeve brenda portit.

10.3. Organizata e peshkimit bashkëpunon me kapitanerinë dhe regjistrin detar për ndjekjen në vazhdimësi të çështjeve që lidhen me sigurimin e lundrimit të anijeve mbi bazën e konventave ndërkombëtare.

10.4. Organizata e peshkimit bashkëpunon dhe i krijon kushtet e duhura administratës doganore në mënyrë që ajo të kryejë detyrat funksionale të saj brenda territorit të portit të peshkimit.

10.5. Organizata e peshkimit bashkëpunon me policinë kufitare dhe migracionit, me qëllim që të sigurojë zhvillimin normal të veprimtarive në portin e peshkimit.

---

[1] Kjo dispozitë aplikohet vetëm për OP-të.

Neni 11
Dokumentacioni

11.1. Dokumentacioni i procedurës së transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së portit të peshkimit/tregut të shitjes me shumicë mbahet në institucionin përgjegjës për peshkimin dhe akuakulturën dhe një kopje e tij i dërgohet edhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

11.2. Institucioni përgjegjës për peshkimin dhe akuakulturën dhe OP-ja/njësia e vetëqeverisjes vendore kryejnë inventarin e portit të peshkimit/tregut, të cilin e merr në ngarkim së bashku me dokumentacionet përkatëse.

Neni 12
Mbarimi i marrëveshjes

12.1. Kjo marrëveshje mbaron kur përfundon afati i përcaktuar në nenin 3 të saj;

12.2. Kjo marrëveshje mbaron para afatit të përcaktuar në nenin 3 të saj:

a) kur organizata e peshkimit shpërndahet;

b) kur organizata e peshkimit/njësia e vetëqeverisjes vendore nuk kryen administrimin sipas kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje;

c) kur organizata e peshkimit/njësia e vetëqeverisjes vendore shkel parashikimet e ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar;

ç) për shkelje të përsëritura që cenojnë kryerjen e aktiviteteve të peshkimit ose ndryshohet destinacioni për të cilin është kryer transferimi;

d) kur nuk përmbushen detyrimet sipas planit të menaxhimit, mbi të cilin është kryer transferimi.

dh) me mirëkuptim mes palëve.

Neni 13
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

13.1. Palët respektojnë legjislacionin shqiptar në fuqi dhe përpiqen që mosmarrëveshjet, të cilat mund të lindin gjatë zbatimit të saj, t'i zgjidhin me mirëkuptim midis tyre.

13.2. Pala që gjykon se ekziston një mosmarrëveshje, njofton palën tjetër duke bërë një përshkrim të plotë të çështjeve që kërkojnë zgjidhje.

13.3. Personat e autorizuar të palëve të përfshira në mosmarrëveshje duhet të bëjnë personalisht apo nëpërmjet përfaqësuesve të tyre përpjekje për zgjidhjen e mosmarrëveshjes mbi parimin e ruajtjes së vazhdimësisë së punës.

13.4. Nëse personat e autorizuar të palëve apo përfaqësuesit e tyre nuk janë në gjendje të zgjidhin mosmarrëveshjen, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit, njëra palë njofton palën tjetër se çështja nuk është zgjidhur.

13.5. Procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mbikëqyren dhe aprovohen nga ministria.

13.6. Për të gjitha mosmarrëveshjet që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, organi kompetent është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë _____.

Neni 14
Të ndryshme

14.1. Kjo marrëveshje nënshkruhet në 4 kopje origjinale, nga 2 për secilën palë.

14.2. Çdo ndryshim i kësaj marrëveshjeje duhet të negociohet ndërmjet palëve dhe të bëhet me shkrim.

14.3. Të gjitha kushtet e parashikuara në ligjin nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, legjislacionin tjetër në fuqi të aplikueshëm në menaxhimin e infrastrukturës, dhe vendimin, "Për përcaktimin e kushteve dhe procedurave të transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit tek organizatat e peshkimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe subjektet private", janë drejtpërdrejt të zbatueshme në këtë marrëveshje.

PALËT NËNSHKRUESE

Përfaqësuar nga: